



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

Nr. \_\_ 62\_\_ Prot.

**UDHËZIM**

Nr. \_02\_, Datë\_11. 04. 2017

I MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR.02, DATË 30.11.2017

**PËR**

**VLERËSIMIN E PROJEKTEVE QË FINANCOHEN NË KUADRIN E  
PROGRAMEVE KOMBËTARE TË KËRKIMIT DHE TË ZHVILLIMIT**

**Viti 2017**

## **A. Përmbajtja e Udhëzimit**

|             |   |   |
|-------------|---|---|
| <b>I.</b>   | Ç' është proçesi i vlerësimit dhe pse bëhet.      | 4 |
| <b>II.</b>  | Si bëhet vlerësimi.                               | 5 |
| <b>III.</b> | Vlerësimi afatmesëm i projekteve.                 | 5 |
| <b>IV.</b>  | Vlerësimi përfundimtar i projekteve.              | 6 |
| <b>V.</b>   | Hapat e procesit të vlerësimit.                   | 6 |
| <b>VI.</b>  | Shpërblimi i ekspertëve të misionit të vlerësimit | 7 |

## **B. Anekset**

|             |  |    |
|-------------|--|----|
| <b>I.</b>   | Skema e raportit të vlerësimit afatmesëm.      | 8  |
| <b>II.</b>  | Skema e raportimit të vlerësimit përfundimtar. | 11 |
| <b>III.</b> | Fjalorth i termave të përdorura.               | 13 |
| <b>IV.</b>  | Kontrata e ekspertizës.                        | 15 |
| <b>V.</b>   | Autorizimi për kryerjen e ekspertizës          | 16 |

## I. P A R A T H Ë N I E

Ky Udhëzim është një paketë informacioni dhe instruksionesh për ekspertët e thirrur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, për të kryer vlerësimet afatmesëm ose përfundimtare të projekteve të financuara prej tyre.

Ai ju jepet ekspertëve:

- për t'u njohur përpara fillimit të misionit të vlerësimit;
- si material referimi në terren, i nevojshëm gjatë tërë aktivitetit të vlerësimit;
- si kujtesë e çështjeve që duhet të trajtohen në raportin e vlerësimit, që përpilohet në mbarim të misionit të vlerësimit.

Ky udhëzim ka për qëllim:

- të sigurojë një raport vlerësimi, i cili do të ndihmojë në përmirësimin e punës dhe rritjen e cilësisë së projektit;
- ta bëjë procesin e vlerësimit më të lehtë dhe efikas;
- të unifikojë procedurat e vlerësimit dhe t'i bëjë ato më të thjeshta.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

Nr.   62   Prot

**UDHËZIM**

Nr.   02  , Datë   11. 04. 2017  

**PËR**

**VLERËSIMIN E PROJEKTEVE QË FINANCOHEN NË KUADRIN E PROGRAMEVE  
KOMBËTARE TË KËRKIMIT DHE TË ZHVILLIMIT**

Në bazë të Ligjit Nr. 7893, datë 22.12.1994, "Për Shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik", të VKM. Nr. 607, datë 31.08.2016, "Për Krijimin, Përbërjen, Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit", (AKKSHI), dhe në bazë të VKM Nr. 567, datë 23. 10.1995, "Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike", Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

**UDHËZON:**

**I. Ç' është procesi i vlerësimit dhe pse bëhet?**

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të drejtimit të çdo aktiviteti shkencor. Ai ndihmon në marrjen e vendimeve. Atij i nënshtrohen të gjitha projektet që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit.

Ai nevojitet për të evidentuar gjendjen reale të ecurisë së projekteve dhe për të përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e saj, për të nxjerrë përfundime të drejta lidhur me vlerën e vetë projekteve, si dhe mësimet në lidhje me projektet dhe programet e ardhshme.

Vlerësimi është një proces që ka si aspekt kryesor evidencimin dhe vlerësimin e rezultatit shkencor të projektit, si dhe problemet administrative, financiare, etj.

Gjatë vlerësimit të një projekti vihet theksi në çështjet kryesore të mëposhtme:

- Vlefshmëria e projektit në momentin e vlerësimit: A i qëndrojnë kohës qëllimi dhe objektivat e vëna në projekt?

- Efektiviteti: A i ka arritur projekti objektivat e tij?
- Efikasiteti: Çfarë rezultatesh janë arritur dhe me ç'kosto?
- Vijueshmëria: A mund të vazhdohet më tej puna mbi bazën e rezultateve të arritura nga ky projekt pa financim të mëtejshëm nga organi përgjegjës.
- Ndikimi: Çfarë pasojash ka projekti në mjedisin institucional, shkencor, teknologjik, ekonomik dhe shoqëror?

Në grupin e vlerësimit nuk përfshihen persona të cilët kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në aktet e hartimit, miratimit, zbatimit dhe drejtimit të projektit.

Vlerësimi i projekteve mund të bëhet:

1. kur projekti është në vazhdim (*vlerësimi afatmesëm*);
2. kur projekti sapo ka përfunduar (*vlerësimi përfundimtar*);
3. kur projekti ka kohë që ka përfunduar (*Ex-Post*).

Vlerësimi afatmesëm dhe përfundimtar zbatohet për të gjithë projektet, ndërsa ai "Ex-Post" për ato projekte për të cilat vlerësimi i rezultateve dhe i përfitimeve nga projekti ka qënë i vështirë për t'u përcaktuar në momentin e vlerësimit përfundimtar.

Raporti i misionit të vlerësimit është prodhim i një pune të pavarur dhe si i tillë nuk mund të ndryshohet prej *askujt*.

## **II. Si bëhet vlerësimi**

Procesi i vlerësimit bëhet në institucionin ku realizohet projekti (agjencia ekzekutive).

Grupi i eksperteve për realizimin e misionit të tij, bashkëpunon me personelin e projektit, me drejtuesit e institucionit, me Drejtorinë e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit (DKPKKZH) në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) për projektet e financuara nga AKKSHI dhe njëkohësisht merr kontakt me përdoruesit potencialë të rezultateve të projektit.

Në procesin e vlerësimit të projektit shfrytëzohet një informacion i shumëllojshëm nëpërmjet dokumentave të mëposhtëm:

- Dokumenti i Programit Kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit në kuadrin e të cilit financohet projekti.
- Dokumenti i projektit sipas kontratës të nënshkruar.
- Planet vjetore dhe operative të punës.
- Raportet e vlerësimit të projektit nga vetë institucioni.
- Dokumentacioni me të dhënat primare të vrojtimit, eksperimentimeve, etj., si dhe të gjitha dokumentet e tjera të përpiluara në kuadrin e kryerjes së projektit (llogaritje, vizatime, etj.).
- Botimet e bëra rreth problemeve që trajton projekti.
- Literatura e konsultuar nga grupi kërkimor.
- Intervistat me studiues të ndryshëm dhe përdoruesit potencial të rezultateve të projektit.
- Dokumentacioni financiar i projektit.
- Pyetsorë, etj.

### **III. Vlerësimi afatmesëm i projektit**

Vlerësimi afatmesëm ka për qëllim që të jetë një mekanizëm korigjues, që diagnostikon problemet e ndeshura dhe sugjeron korigjimet që duhen bërë për të siguruar ecuri normale në realizimin e projektit.

Vlerësimi afatmesëm *synon* të kontrollojë këto aspekte:

- ◆ Aktualitetin e objektivave të projektit.
- ◆ Rezultatet e aktiviteteve të realizuara, të krahasuara me ato të planit të punës.
- ◆ Efektiviteti i rrugës së ndjekur për arritjen e rezultateve.
- ◆ Kufizimet kryesore të ndeshura në proces dhe ndikimi i tyre mbi rezultatet.
- ◆ Ecuria e inputeve.
- ◆ Sa efektiv është sistemi i vendosur për monitorimin e ecurisë së projektit.

Vlerësimi afatmesëm sqaron çështjet sipas Skemës në Aneksin Nr.1, mbi bazën e së cilës ndërtohet Raporti i Misionit të Vlerësimit.

Raporti i Vlerësimit dorëzohet jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të Misionit. Raporti firmoset nga të gjithë pjesëmarrësit e grupit të vlerësimit. Mbi bazën e analizave të bëra, grupi i ekspertëve, në Raportin e Vlerësimit propozon ndryshimet përkatëse në dokumentin dhe në planet e punës. Ai ka të drejtë të propozojë deri në ndërprerjen e financimit të projektit, kur ka bindje se vazhdimi i mëtejshëm i tij është i padobishëm. Mbi bazën e këtyre propozimeve organi që financon projektin merr vendimin përkatës.

### **IV. Vlerësimi përfundimtar i projektit**

Vlerësimi përfundimtar i projektit, si rregull, bëhet menjëherë pas mbarimit të tij. Ai trajton po ato çështje si dhe vlerësimi afatmesëm, por *fokuset* në rezultatet e arritura nga projekti dhe në *ndikimin e pritshëm* të tyre. Ai bën një vlerësim të ecurisë së përgjithshme të projektit, si dhe jep rekomandime në lidhje me mundësinë e vazhimit të mëtejshëm të tij në drejtimet e përcaktuara me interes, kur kjo gjykohet e përshtatshme. Paraqitja e Raportit të Vlerësimit Përfundimtar bëhet sipas së njëjtës procedure që jepet me lart për vlerësimin afatmesëm dhe sipas skemës në Aneks II.

### **V. Hapat e procesit të vlerësimit**

#### **Hapi 1.**

- Njohja me Udhëzimin për Vlerësimin e Projekteve që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit.
- Njohja me Programin Kombëtar të Kërkimit dhe të Zhvillimit në fushën e projektit.
- Njohja me dokumentacionin ekzistues në lidhje me projektin.
- Lidhja e kontratës për kryerjen e misionit të vlerësimit ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe grupit të vlerësimit.
- Dhënia e dokumentave të nevojshëm për kryerjen e vlerësimit (Procedura për vlerësimin, dokumenti dhe kontrata e projektit, informacionet periodike, raporti përfundimtar për rastin kur ka përfunduar projekti dhe autorizimi për fillimin e punës të misionit).
- Përgatitja e planit të punës nga ana e grupit të vlerësimit.

**Hapi 2.** *Takim me personelin e projektit dhe drejtuesit e institucionit.*

- Takim me drejtuesit e institucionit dhe të grupit kërkimor për të diskutuar e finalizuar planin e punës të misionit të vlerësimit.

**Hapi 3.** *Mbledhja e informacionit.*

- Vjelja e të dhënave të nevojshme dokumentare për vlerësimin e projektit.
- Kontakt me personelin që lidhet me projektin, me përfituesit potencialë të rezultateve të projektit dhe persona të tjere që kanë përvojë në këtë fushë.

**Hapi 4.** *Analiza e informacionit.*

Shqyrtimi i konceptit dhe shtjellimit të projektit nga pikëpamja e aktualitetit, vlefshmërisë dhe plotshmërisë.

Shqyrtimi i përvojës së zbatimit të projektit nga pikëpamja e cilësisë dhe afateve kohore të punës së kryer, duke krahasuar dhe vënë në dukje edhe diferencat me planin e punës.

Shqyrtimi i kufizimeve të ndeshura gjatë zbatimit dhe sa kanë ndikuar ato në realizimin e projektit.

Shqyrtimi i efektivitetit të projektit nga pikëpamja e realizimit të komponenteve të tij, të aktiviteteve të ndërmarra, kostos së tyre dhe rezultateve të arritura. Evidencimi i kujdesshëm i rezultateve dhe i objektivave të arritura. A ka patur mosrealizime dhe pse?

**Hapi 5.** *Përgatitja e skicë-raportit të vlerësimit të projektit.*

- Përgatitja e versionit të parë të raportit.
- Rishikimi i skicë-raportit të vlerësimit me drejtuesit e projektit dhe të institucionit ku zbatohet, për të kontrolluar gabimet e mundshme faktuale.

**Hapi 6** *Përfundimi dhe dorëzimi në Agjencinë Kombëtare të Kerkimit Shkencor dhe Inovacionit i Raportit Përfundimtar të Vlerësimit të Projektit.*

**VI. Shpërblimi i ekspertëve të misionit të vlerësimit.**

Grupi i ekspertëve shpërblehet me vlerën e plotë të ditëve të punës të nevojshme për bërjen e vlerësimit, të pagës së titullit "Prof", të specifikuar me kontratën lidhur ndërmjet palëve sipas modelit që jepet në Aneksin IV.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**GERON KAMBERI**

## **SKEMA E RAPORTIT TË VLERËSIMIT AFATMESËM**

### **I. Konceptimi dhe shtjellimi i përgjithshëm i projektit**

1. A konsiderohet i përshtatshëm konceptimi i përgjithshëm, shtjellimi si dhe rregullimi institucional, për kohën kur është miratuar projekti? Si qëndron kjo çështje në lidhje me momentin aktual.
2. A janë në pajtueshmëri objektivat e projektit me objektivat e programeve kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit të fushës përkatëse.

### **II. Dokumenti i Projektit**

1. A janë përcaktuar dhe formuluar drejt titulli, qëllimi, objektivat, inputet, fazat e realizimit të projektit, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme të tij?
2. Si pasqyrohet rregullimi institucional?
3. A janë pasqyruar rrisqet e mundshme?
4. A janë identifikuar qartë përfituesit nga projekti?
5. A konsiderohet i drejtë mekanizmi i monitorimit të projektit, i parashikuar në dokumentin e tij (plani i përgjithshëm, planet vjetore operative të punës, etj.)?

### **III. Zbatimi i Projektit**

1. A janë zbatuar aktivitetet e projektit sipas planeve të punës.
2. Si është drejtuar projekti nga ana administrative e financiare? A ka patur vështirësi financiare të cilat kanë penguar zbatimin normal të projektit? A janë përdorur fondet në përputhje me dokumentin e projektit?
3. Si ka qenë bashkëpunimi ndërinstitucional në kuadrin e zbatimit të projektit.
4. A ka patur ndryshime institucionale si dhe lëvizje të personelit të projektit gjatë zbatimit dhe me çfarë efekte?



5. Cilat kanë qenë kufizimet dhe risqet kryesore që kanë penguar zbatimin e projektit. A janë parashikuar ato në dokumentin e tij? Çfarë masash janë marrë nga institucioni zbatues i projektit për kapërcimin e tyre? Cilat janë rekomandimet në lidhje me këtë çështje?
6. Çfarë monitorimi dhe vlerësimi i është bërë projektit nga vetë institucioni?
7. A janë të vlefshme të dhënat bazë të përdorura, si dhe supozimet e bëra në kuadrin e shtrimit dhe zgjidhjes së problemeve?
8. Si e vlerësoni trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve nga pikpamja metodologjike dhe përgjithsisht niveli shkencor (teknikat eksperimentale dhe metodat e përdorura për mbledhjen e përpunimin e të dhënave, për modelin, zgjidhjet shkencore dhe/ose teknologjike?
9. Si vlerësohet niveli i personelit të projektit dhe a është në gjendje ai ta përfundojë me sukses atë?

#### **IV. Rezultatet e Projektit**

1. A janë arritur të gjitha rezultatet e parashikuara në dokumentin e projektit?
2. Cilat janë rezultatet e arritura, afatet kohore, cilësia dhe kostua e tyre? A ka ndërmjet tyre rezultate të paparashikuara në dokumentin e projektit dhe cilët janë ata?
3. Cilat rezultate nuk janë arritur dhe pse? Çfarë ndikimi ka patur mosarritja e tyre në ecurinë e përgjithshme të projektit.
4. Cilat objektiva imediate të projektit janë arritur? Mbi bazën e cilëve rezultate të arritura vlerësohet plotësimi i secilës prej tyre?

#### **V. Konkluzione dhe Rekomandime**

1. Cilat janë konkluzionet më të rëndësishme që dalin nga vlerësimi i projektit?
2. Cilat janë rekomandimet e misionit të vlerësimit në lidhje me ecurinë e mëtejshme të projektit?
3. Çfarë masash duhen marrë për të garantuar përfundimin me sukses të tij?

Shënim: Kapaku i raportit formulohet sipas fletës bashkëlidhur.

## **ORGANI QE FINANCON PROJEKTIN**

**TITULLI I PROJEKTIT .....**

**NUMRI I PROJEKTIT .....**

## **RAPORT I MISIONIT TE VLERËSIMIT (AFATMESEM / PËRFUNDIMTAR)**

**GRUPI I MISIONIT**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

DATA \_\_\_\_\_

## **SKEMA E RAPORTIMIT TE VLERËSIMIT PËRFUNDIMTAR**

### **I. Konceptimi dhe shtjellimi i përgjithshëm i projektit**

1. A konsiderohet i përshtatshëm konceptimi i përgjithshëm, shtjellimi si dhe rregullimi institucional, për kohën kur është miratuar projekti? Si qëndron kjo çështje në lidhje me momentin aktual.
2. A janë në pajtueshmëri objektivat e projektit me objektivat e programeve kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit të fushës përkatëse.

### **I. Dokumenti i Projektit**

1. A janë përcaktuar dhe formuluar drejt titulli, qëllimi, objektivat, inputet, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme të tij?
2. Si pasqyrohet rregullimi institucional?
3. A janë pasqyruar rrisqet e mundshme?
4. A janë identifikuar qartë përfituesit nga projekti?
5. A konsiderohet i drejtë mekanizmi i monitorimit të projektit, i parashikuar në dokumentin e tij (plani i përgjithshëm, planet vjetore operative të punës, etj.)?

### **I. Zbatimi i Projektit**

1. A janë zbatuar aktivitetet e projektit sipas planeve të punës.
2. Si është drejtuar projekti nga ana administrative e financiare? A ka patur vështirësi financiare të cilat kanë penguar zbatimin normal të projektit? A janë përdorur fondet në përputhje me dokumentin e projektit?
3. Si ka qenë bashkëpunimi ndër-institucional në kuadrin e zbatimit të projektit.
4. A ka patur ndryshime institucionale si dhe lëvizje të personelit të projektit gjatë zbatimit dhe me çfarë efekte?
5. Cilat kanë qenë kufizimet dhe risqet kryesore që kanë penguar zbatimin e projektit. A janë parashikuar ato në dokumentin e tij? Çfarë masash janë marrë nga institucioni zbatues i projektit për kapërcimin e tyre? Cili është mendimi juaj në lidhje me zgjidhjet e dhëna?
6. Çfarë monitorimi dhe vlerësimi i është bërë projektit nga vetë institucioni?
7. A janë të vlefshme të dhënat bazë të përdorura e bëra në kuadrin e shtrimit dhe zgjidhjes së problemeve?

8. Si e vlerësoni trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve nga pikpamja metodologjike dhe përgjithsisht niveli shkencor (teknikat eksperimentale dhe metodat e përdorura për mbledhjen e përpunimin e të dhënave, për modelin, zgjidhjet shkencore dhe/ose teknologjike?
9. Si vlerësohet niveli i personelit të projektit dhe a është në gjendje ai ta përfundojë me sukses atë?

#### **IV. Rezultatet e Projektit**

1. A janë arritur të gjitha rezultatet e parashikuara në dokumentin e projektit?
2. Cilat janë rezultatet e arritura, cilësia dhe kostua e tyre? A ka ndërmjet tyre rezultate të paparashikuara në dokumentin e projektit dhe cilët janë ata?
3. Cilat rezultate nuk janë arritur dhe pse? Çfarë ndikimi ka patur mosarritja e tyre në ecurinë e përgjithshme të projektit.
4. Cilat objektiva imediate të projektit janë arritur? Mbi bazën e cilëve rezultate të arritura vlerësohet plotësimi i secilës prej tyre? Cilat objektiva nuk janë arritur dhe pse?
5. A kontribon arritja e objektivave imediate të projektit në objektivin e zhvillimit të formuluar në dokumentin e projektit?
6. Si vlerësohet afati dhe financimi i bërë për projektin në raport me rezultatin e arritur?
7. A mund të vazhdohet më tej puna mbi bazën e rezultateve të këtij projekti pa financim të metejshëm nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit që ka financuar projektin?
8. Si i vlerësoni rekomandimet e dhëna nga projekti (të drejta, të zbatueshme, të mangëta, etj.)?
9. Për çfarë mund të përdoren në të ardhmen rezultatet e arritura nga ky projekt dhe cilët institucione, firma shtetërore e private, etj., krahas atyre të identifikuar në dokumentin e projektit mund të përfitojnë nga rezultatet e tij?

#### **V. Konkluzione dhe rekomandime**

1. Cilat janë konkluzionet më të rëndësishme që dalin nga vlerësimi i projektit?
2. A konsiderohet i arritur projekti?
3. Cilat janë rekomandimet e misionit të vlerësimit për institucionet shtetërore dhe private në lidhje me:
  - a) Zbatimin e rezultateve të projektit.
  - b) Nevojën e trajtimit të mëtejshëm të projektit ose të aspekteve apo problemeve të veçanta të tij, të cilat duket se paraqesin interes për të ardhmen.

Shënim: Kapaku i raportit i njëjtë me atë që jepet në Aneksin I.

## FJALORTH I TERMAVE TË PËRDORURA

Agjensia Ekzekutuese është institucioni, që vetëm ose në bashkëpunim me të tjerë, realizon projektin.

Aktualiteti është shkalla në të cilën arsyet, objektivat dhe ndikimi i pritshëm i një projekti është ose mbetet i vlefshëm dhe i rëndësishëm në lidhje me objektivat afatgjata ose nevojat dhe shqetësimet prioritare të kohës.

Efektiviteti është matësi i masës në të cilën një projekt arrin objektivat e tij.

Efikasiteti është rendimenti i zbatimit të procesit të një projekti, një tregues që shpreh sa mirë transformohen inputet në rezultate.

Efektiviteti i kostos është një analizë që ka për qëllim të përcaktojë koston dhe efektivitetin e një projekti. Në këtë kuadër mund të krahasohen kostua e disa rrugëve (varianteve) të ndryshme të kryerjes së një projekti, me qëllim që të gjendet varianti me kosto minimale për arritjen e fundit të dëshiruar.

Inputet janë mallrat, shërbimet, personeli dhe burimet financiare që jepen për një projekt nga të cilët pritet nxjerrja e rezultateve dhe arritja e objektivave të tij.

Inspektimi është një kontroll special i bërë në vend, i programuar ose i papritur i një projekti që ka si qëllim zgjidhjen e problemeve që mund të kenë qenë ose jo identifikuar më parë.

Monitorimi është mbikqyrja e vazhdueshme e zbatimit të një projekti. Ai synon të japë siguri se inputet, rezultatet e synuara dhe aktivitetet e tjera të nevojshme vazhdojnë në përputhje me planin.

Ndikimi është shprehja e ndryshimeve të sjella në një situatë si rezultat i zbatimit të projektit. Ai mund të vlerësohet më mirë në afate të gjata, nëpërmjet monitorimit.

Objektivat janë qëllimet e projektit, janë ato që përfaqësojnë gjendjen e dëshiruar që pritet të arrije ai.

Outputet (Rezultatet) janë produktet specifike që projekti pritet të japë nga inputet e tij, me qëllim që të arrihen objektivat e tij.

Përfituesit nga projekti grup njerëzish dhe/ose institucionesh, shtetërore dhe private, që përfitojnë nga projekti. Ato ndahen në:

- Përfituesit direkt, që përfitojnë drejtpërdrejtë nga inputet dhe aktivitetet e projektit;
- Përfituesit indirekt që përfitojnë nga zgjidhjet e problemit që trajton projekti, ndonëse nuk marrin pjesë të drejtpërdrejtë në realizimin e tij.

Projekt, është një aktivitet i planifikuar që ka për qëllim arritjet e disa objektivave, nëpërmjet mjeteve të specifikuara, brenda një periudhe të caktuar kohe dhe mbështetje financiare.

Revizioni është një rishikim që përcakton se në çfarë mase një kusht, proces ose rezultat është në përputhje me standardet dhe kriteret e paracaktuara dhe raporton mbi masën e kësaj përputhje.

Treguesit janë matësit objektivë dhe specifikë të ndryshimeve ose rezultateve të pritshme të një projekti. Ata konceptohen për të dhënë një shkallë përkundrejt së cilës të matet dhe tregohet progresi i projektit, nëpërmjet arritjes së rezultateve dhe objektivave të tij. Ata mundet gjithashtu të shihen si objektiva specifike. Ata mund të kategorizohen sipas tipit, si tregues të rezultateve ose tregues të ndikimit.

Vijueshmëria nënkupton vazhdimësinë e rezultateve pozitive ose të zbatimit të arritjeve të projektit, pasi investimi për projektin ka përfunduar.

Vlerësimi është një proces që synon të përcaktojë në mënyrë sa më sistematike dhe objektivisht rëndësinë, efektivitetin dhe ndikimin e një projekti nën dritën e objektivave të tyre. (Ai është një instrument drejtimi dhe një proces organizativ i nxjerrjes së mësimave dhe i orientimit drejt veprimit për përmirësimin e aktiviteteve që janë në proces, si dhe për planifikimin, programimin dhe marrjen e vendimeve për të ardhmen).

Vlerësimi i brendshëm është analiza e projektit që kryhet prej personelit të projektit, pra është një aktivitet vetëvlerësimi.

Vlerësimi Ex-Post, është analiza, mbasi ka kaluar një farë kohe nga mbarimi i një projekti, e rëndësisë, efektivitetit dhe e ndikimit të tij. Nëpërmjet vlerësimit të rezultatit të aktivitetit dhe përmbledhjes së mësimave të nxjerra prej tij, ai ndihmon drejtuesit për planifikimin e ardhshëm.

Vlerësimi i jashtëm është analiza e projektit që kryhet nga ekspertë të palidhur me projektin.

Vlerësimi afatmesëm është analiza gjatë fazës së zbatimit të një projekti në lidhje me vazhdimësinë e aktualitetit të tij, si dhe rezultatet, efektivitetin dhe ndikimin e tanishëm dhe të pritshëm.

Vlerësimi përfundimtar, është analiza menjëherë mbas mbarimit të një projekti e rëndësisë, efektivitetit dhe e ndikimit të tij. Nëpërmjet vlerësimit të rezultateve të projektit dhe mësimave të nxjerra prej tij ai ndihmon edhe për planifikimin e ardhshëm.



## K O N T R A T Ë

Nr. \_\_\_\_ Prot

Tiranë, më ...../...../.....

**Për kryerjen e Misionit të Vlerësimit për Pranim Projekti**

Sot më datë ..... lidhet kjo kontratë ndërmjet:

Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), institucion financues, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Geron Kamberi**

dhe Eksperti i Komisionit të Vlerësimit **Z. \_\_\_\_\_**, për:

**“Kryerjen e vlerësimit përmbajtësor për pranim të projekt-propozimeve të paraqitura pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit që kërkohen të financohen në kuadër të Thirrjes për Aplikim me projekte në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, datë ...../...../..... duke iu përmbajtur kushteve të mëposhtme:**

- I. Para nënshkrimit të kësaj Kontrate vlerësuesi duhet të jetë dakord e të firmosi “Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit”, (bashkangjitur kësaj kontrate) bazuar në **Udhëzimin Nr. 01, datë 11.04.2017** të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit për “Procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit”, pika 3c, i cili thekson se :

*“Pjesëtarë të grupit të Komisioneve të Ekspertëve të Vlerësimit zgjidhen nga specialistë të fushave përkatëse që nuk janë pjesëtarë të personelit të projektit ose të organeve vendimmarrëse të institucioneve që e kanë propozuar atë”.*

- II. Ekspertët do të kryejnë vlerësimin duke plotësuar të gjitha rubrikat e “Skedës së Raportit të Misionit të Vlerësimit të projekt – propozimit”. Pasi bën vlerësimin e projekt-propozimit, komisioni i ekspertëve paraqet raportin e vlerësimit për pranimin apo refuzimin e tij sipas skedës të ekspertëve të vlerësimit e cila u vihet në dispozicion ekspertëve nga specialistët e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

- III. Komisioni i Ekspertëve shpërblehet për punën e kryer bazuar në VKM Nr. 567, datë 23.10.1995, “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike”.
- IV. Ekspertët do të dorëzojnë ekspertizën brenda datës së caktuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.
- V. Në rast mos respektim të datës së dorëzimit të ekspertizës organi financues mund të marrë këto sanksione:
  - a. Pagesë të pjesshme të ekspertit.
  - b. Mos pagesë të ekspertit.
  - c. Mos aktivizim të ekspertit në ekspertiza të ardhshme.

Kontrata u përgatit në tre kopje (dy për organin financues dhe një për ekspertin).

Palët pasi e lexuan dhe e gjetën kontratën konform ligjit dhe interesave të tyre, e nënshkruan atë.

**EKSPERTI I VLERËSIMIT**

**PËRFAQËSUESI I ORGANIT FINANCUES**

**GERON KAMBERI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

**AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 201....

INSTITUTIT \_\_\_\_\_

UNIVERSITETIT \_\_\_\_\_

Z. \_\_\_\_\_

---

janë caktuar për kryerjen e vlerësimit afatmesëm / përfundimtar të projektit

---

të financuar në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit.

Të vihen në dispozicion të tyre grupi kërkimor dhe dokumentacioni i projektit, si dhe të krijohen të gjitha lehtësitë e kushtet për kryerjen e këtij vlerësimi.

Vlerësimi do të fillojë në datën \_\_\_\_\_.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**GERON KAMBERI**

